



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 702/2022

Lidhur me shkeljet e parimeve të miradministrit me rastin e shpalljes së konkurseve dhe dështimit të institucioneve publike në përmbushjen e kuotës për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë

Drejtuar:

Z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Z. Xhelal Sveçla, Minister
Ministria e Punëve të Brendshme

Kopje:

Z. Habit Hajredini
Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 4 mars 2025

QËLLIMI I RAPORTIT

1. Qëllimi i këtij Raporti me rekomandime është tërheqja e vëmendjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndaj të cilit është paraqitur kjo ankesë, lidhur me detyrimet për të vepruar në pajtim me parimet e miradministrimit, me rastin e procedurave të rekrutimit.
2. Qëllim i këtij raporti është po ashtu tërheqja e vëmendjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) në lidhje me përmbushjen e obligimeve kushtetuese dhe ligjore për përfaqësimi në punësim në institucionet publike të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në Republikën e Kosovës.

BAZA LIGJORE

3. Avokati i Popullit, në mes të tjerash, sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *Avokati i Popullit mund të jep rekomandime dhe të propozoj masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve tjera shtetërore; (neni 135, paragrafi 3 i Kushtetutës);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla; (neni 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit);*
 - *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit; (neni 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit);*
 - *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; (neni 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit);*
 - *të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; (neni 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 i Ligjit);*
 - *të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës; (neni 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.8 i Ligjit).*

RRETHANAT E RASTIT

4. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 20 dhjetor 2022 kishte pranuar ankesën e [REDAKTUAR], parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), përkitazi me pretendime për cenimin e së drejtës së punës dhe të ushtrimit të profesionit.
5. Sipas pohimeve të ankuesit, ai kishte aplikuar në pozitën e punës "Zyrtar për buxhet dhe financa" në KQZ, sipas konkursit publik, të shpallur më 16 nëntor 2022, për rekrutim për

zgjedhjet e jashtëzakonshme të datës 18 dhjetor 2022. Përveç kësaj pozite pune, konkurs ishte shpallur edhe për 69 pozita të tjera.

6. Më tej ankuesi ka njoftuar se ai ishte ftuar në intervistë, por nuk ishte njoftuar zyrtarisht për rezultatin e aplikimit dhe se këtë e kishte kuptuar nga kandidatët e tjerë të suksesshëm, të cilët tashmë i kishin nënshkruar kontratat e punës. Për më tepër, ankuesi ka njoftuar se ai i takon njërit prej komuniteteve joshumicë dhe se institucionet publike janë të detyruara ta zbatojnë legjislacionin që ka të bëjë me punësimin e komuniteteve joshumicë në Kosovë.
7. Më 12 dhjetor 2022, nëpërmjet postës elektronike, ankuesi i ishte drejtuar kryesuesit të KQZ-së, lidhur me çështjen, por nuk kishte marrë përgjigje.
8. Më 9 mars 2023, Avokati i Popullit i ishte drejtuar me shkresë KQZ-së, me ç’ rast kishte kërkuar informata mbi kërkesën e parashtruar nga ankuesi, të datës 12 dhjetor 2022, si dhe informata lidhur me veprimet që ndërmerren nga ky institucion për njoftimin e kandidatëve kur ata aplikojnë në konkurse rekrutimi; nëse kishin vepruar njëjtë me të gjithë kandidatët e tjerë, të cilët nuk kishin arritur të përzgjidheshin apo i kishin njoftuar vetëm kandidatët të cilët kishin hyrë në përzgjedhjen e ngushtë.
9. Më 6 prill 2023, Avokati i Popullit kishte marrë përgjigje nga KQZ-ja, ku thuhej se për shkak të natyrës urgjente të zgjedhjeve të jashtëzakonshme, për rezultatin e procedurave rekrutuese ishin njoftuar vetëm kandidatët që ishin përzgjedhur. Asnjë kandidat, i cili nuk ishte përzgjedhur në pozita pune jopermanente, sikur që ishte edhe pozita për të cilën kishte aplikuar ankuesi, nuk ishte njoftuar zyrtarisht. Sipas KQZ-së, kjo praktikë ishte ndjekur në çdo proces zgjedhor, për shkak të numrit të madh të aplikuesve dhe procedurave të shpejta që duheshin përfunduar. Më tej në përgjigje thuhej se ankuesi ishte përzgjedhur më vonë, sipas një konkursi tjetër publik, të datës 2 mars 2023, si staf jopermanent, në pozitë pune “Zyrtar për Buxhet dhe Financa”, për periudhë kohore dymujore, nga 24 mars 2023 deri më 23 maj 2023.
10. Avokati i Popullit, duke marrë shkas nga ky rast, jo vetëm për nga aspekti i udhëheqjes së procedurave të rekrutimit, por edhe lidhur me punësimin e komuniteteve joshumicë në sektorin publik, më 30 gusht 2024 i kishte dërguar një shkresë Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), për të kërkuar informata lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkitazi me përfaqësimin e komuniteteve joshumicë, që sipas ligjit duhet të jetë 10% në nivel qendror. Avokati i Popullit kishte kërkuar informata nëse kuota prej 10% nënkupton që secili institucion publik në nivel qendror duhet që minimum 10% e vendeve të punës të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve apo nëse ky 10% i vendeve të punës nënkupton së bashku në të gjitha institucionet publike qendrore. Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar informata statistikore të të punësuarve në institucionet publike qendrore (përfshirë agjencitë dhe institucionet e pavarura), të ndara sipas përkatësisë etnike.
11. Më 30 shtator 2024, Avokati i Popullit kishte marrë përgjigje nga MPB-ja, sipas së cilës, Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, edhe pas shfuqizimit, por edhe me Ligj të ri për Zyrtarë Publikë, përcakton të njëjtën dispozitë për kuotën prej 10% të vendeve të punës për komunitetet joshumicë në nivel qendror në institucione publike, por që ligji në fjalë nuk e ka specifikuar që kjo përqindje të arrihet në secilin institucion publik, por si një tërësi, njëjtë sikurse përcaktohet edhe në Rregulloren 15/2023 për Procedurën e Pranimit

në Shërbimin Civil. Gjithashtu, në këtë përgjigje të MPB-së thuhej se institucionet publike, me qëllim të plotësimit të kuotës së përfaqësimit të komuniteteve joshumicë, mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të nënpërfaqësuar.

12. Sipas statistikave të dërguara nga MPB-ja, vërehej se të dhënat statistikore ishin të vitit 2022. Raporti për numrin e të punësuarve nga radhët e komuniteteve joshumicë në shërbimit civil, i ndarë sipas përkatësisë etnike në institucione shtetërore në nivel qendror, tregon: 92.2% janë të punësuar shqiptarë, 4.1% serbë, 0.8% boshnjakë, 0.6% turq, 0.6 të tjerë dhe 2.4% të padeklaruar. Sipas të dhënave të dërguara vërehej se nuk ka të dhëna për komunitetet e tjera joshumicë në Kosovë, përfshirë romët, ashkalinjtë, egjiptianët, kroatët dhe malazezët. Nuk ka ndonjë sqarim apo arsye shtesë për mospërfshirjen e këtyre komuniteteve në të dhëna statistikore të dërguara nga MPB-ja.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

13. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës.

14. Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, i Kushtetutës, përcakton:

“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”; dhe

“Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”

15. Neni 22 i Kushtetutës përcakton:

“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.”

16. Neni 24, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton si në vijim: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*

17. Neni 61 i Kushtetutës [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike] përcakton:

“Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike.”

18. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, që është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës, inkurajon shtetet anëtare të sigurojnë barazi të plotë dhe efektive për pakicat në të gjitha fushat e jetës, përfshirë punësimin. Kjo Konventë, në mes të tjerash, mbështet masat për të luftuar përjashtimin.

Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

19. Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (më tej: LPPA), neni 3, par. 2, përcakton:

“Procedura administrative është tërësia e renditur sipas ligjit e veprimeve procedurale dhe materiale të njëpasnjëshme të organit publik, që ka për qëllim përgatitjen dhe vendimmarrjen për një veprim konkret administrativ, shqyrtimin e mjeteve juridike administrative, si dhe ekzekutimin e aktit administrativ.”

20. LPPA, neni 4 [Parimi i ligjshmërisë], përcakton:

1. *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.*
2. *Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.*

21. LPPA, neni 9 [Parimi i administratës së hapur], përcakton:

1. *Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.*
2. *Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj.*
3. *Të drejtat e parashikuara nga ky nen, kufizohen me ligj, kur është e domosdoshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të të dhënave personale apo të dhënave afariste e profesionale, të mbrojtura sipas ligjit.*

22. LPPA, neni 108 [Parimi i njoftimit të përshtatshëm], përcakton:

1. *Të njoftuarit është komunikimi i qëllimtë nga një organ publik i një akti administrativ apo procedural, palës apo një personi tjetër i përfshirë në procedurën administrative (në vijim: “pala”).*
2. *Nëse nuk parashihet shprehimisht ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të përcaktojë formën më të përshtatshme të të njoftuarit të një akti administrativ apo të çdo njoftimi tjetër në kuadër të zhvillimit të procedurës administrative, mjeteve juridike apo të ekzekutimit.*
3. *Forma e njoftimit përcaktohet duke pasur parasysh sigurimin e mbrojtjes ligjore të palës, transparencën dhe kosto-efektivitetin e saj.*

23. Rregullorja nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese në Sekretariatit e KQZ-së, neni 49, par. 1, Rregullore kjo mbi bazën e së cilës është shpallur konkursi, përcakton: *“Kur një nëpunës ose kandidat, në një procedurë të rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet në pozitën përkatëse dhe ai/ajo mendon se emërimi i një personi tjetër në atë pozitë nuk është bërë në bazë të meritës ose është bërë si pasojë e parregullsive në zbatimin e rregullave dhe procedurave, ai/ajo mund të ankohet me shkrim në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit, i cili e shqyrton dhe vendos për ankesën.”*

24. Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, neni 10, përcakton:

“Në institucionet publike qendrore, minimum dhjetë për qind (10%) e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.”

25. Rregullorja 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, neni 13 [Kuotat e rezervuara dhe masat afirmative], përcakton:

4. *Kuota e rezervuar për komunitetet jo shumicë, në shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore është së paku dhjetë për qind (10%).*
5. *Institucionet e administratës qendrore sipas paragrafit 1. të këtij neni, përfshijnë Institucionet e Administratës Shtetërore, Institucionet e Pavarura dhe Agjencitë e Pavarura.*
6. *Kuotat e rezervuara për secilin komunitet jo shumicë në shërbimin civil në secilën komunë, përcaktohet në proporcion me popullsinë e atij komuniteti në popullsinë e përgjithshme në komunë, në bazë të të dhënave të regjistrimit zyrtar të popullsisë.*
7. *Institucionet publike me qëllim të plotësimit të kuotës si në paragrafin 1 të këtij neni, mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të nënpërfaqësuar.*
8. *Institucionet publike me qëllim të arritjes së përfaqësimit të barabartë gjinor në institucione publike, mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e gjinisë më pak të përfaqësuar.*
9. *Gjendja e zbatimit të kuotave të rezervuara llogaritet për çdo kategori të pozitive të shërbimit civil.*

ANALIZA LIGJORE

26. Avokati i Popullit çështjes në fjalë do t'i qaset nga aspekti i mosnjoftimit të ankuesit lidhur me rezultatet e konkursit nga ana e KQZ-së; dhe dështimit për ta zbatuar nenin 10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Mosnjoftimi i ankuesit lidhur me rezultatet e konkursit nga ana e KQZ-së

27. Nga komunikimi me ankuesit dhe me KQZ-së, Avokati i Popullit vëren se KQZ-ja fare nuk e ka njoftuar ankuesin lidhur me rezultatin për pozitën e punës “Zyrtar për Buxhet dhe Financa” në KQZ, sipas konkursit publik, të shpallur më 16 nëntor 2022, për rekrutim për zgjedhjet e jashtëzakonshme të datës 18 dhjetor 2022.
28. LPPA-ja definon veprimet procedurale dhe materiale të njëpasnjëshme të organit publik, që ka për qëllim përgatitjen dhe vendimmarrjen për një veprim konkret administrativ, shqyrtimin e mjeteve juridike administrative si dhe ekzekutimin e aktit administrativ.
29. LPPA-ja përcakton se pala ka të drejtën të kërkojë dhe të marrë informacion mbi statusin, progresin e procedurës administrative, si dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë nga organi publik gjatë procedurës. Organi publik, për zhvillimin e procedurës duhet të sigurojë informacion për palën pa vonesë dhe me çdo mjet të përshtatshëm. Në rastin konkret, mbi bazën e informatave të ofruara nga ankuesi, KQZ-ja nuk e ka njoftuar atë për rezultatin nga pjesëmarrja e tij në konkursin publik, të shpallur më 16 nëntor 2022, për

rekrutim për zgjedhjet e jashtëzakonshme të datës 18 dhjetor 2022 dhe kjo pamundëson marrjen e informacionit, sipas kërkesave të lartshënuara ligjore. Për më tepër, ankuesi nuk ka pranuar asnjë informatë tjetër sipas kërkesës së parashtruar përmes postës elektronike të datës 12 dhjetor 2022, dërguar te kryesuesi i KQZ-së.

30. Mosofrimi i informacioneve përkitazi me rezultatet e aplikimit në konkursin publik të shpallur më 16 nëntor 2022, për rekrutim për zgjedhjet e jashtëzakonshme të datës 18 dhjetor 2022, bie ndesh edhe me një parim të rëndësishëm, të përcaktuar në LPPA, atë të administratës së hapur, sipas të cilit: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë; Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj.”*
31. Avokati i Popullit vëren se në rastin e ankuesit, bazuar në pretendimet e tij si dhe në përgjigjen që kemi pranuar nga KQZ-ja, asnjë kandidat për pozitën jopermanente nuk është njoftuar zyrtarisht nga ky institucion, qoftë me shkrim apo nëpërmjet telefonit, praktikë kjo që, sipas Avokatit të Popullit, bie ndesh me dispozitat e LPPA-së.
32. Sipas konkursit publik të shpallur për pozitën e punës “Zyrtar për Buxhet dhe Financa” në KQZ, të datës 16 nëntor 2022, përveç bazave të tjera ligjore, bazë tjetër është Rregullorja nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese në Sekretariatit e KQZ-së, e cila ka paraparë mundësinë e parashtrimit të ankesave kundër vendimeve të përzgjedhjes, sipas nenit 49, par. 1, të rregullores në fjalë, në të cilën përcaktohet se kur një nëpunës ose kandidat, në një procedurë të rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet në pozitën përkatëse dhe ai/a jo mendon se emërimi i një personi tjetër në atë pozitë nuk është bërë në bazë të meritës ose është bërë si pasojë e parregullsive në zbatimin e rregullave dhe procedurave, ai/a jo mund të ankohet me shkrim në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit, i cili e shqyrton dhe vendos për ankesën. Mirëpo ankuesi nuk ishte njoftuar për rezultatin e aplikimit të tij në konkursin e shpallur. Kjo konfirmohet edhe nga përgjigjja e KQZ-së, e datës 6 prill 2023, ku thuhej se për rezultatin e konkursit nuk njoftohet asnjë kandidat, përveç atij/asaj që përzgjidhet në atë pozitë.

Zbatimi i Nenit 10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë

33. Me rastin e paraqitjes së ankesës tek Avokati i Popullit, ankuesi ka vetëdeklaruar përkatësinë e tij etnike. Duke marrë parasysh kuotën që Ligji për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar që në institucionet publike qendrore minimum dhjetë për qind (10%) e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, Avokati i Popullit ka marrë shkas për të kërkuar informata nga MPB-ja lidhur me përqindjen e komuniteteve joshumicë që janë të punësuar në institucione në nivelin qendror. Ndonëse në përgjigjen që kemi pranuar nga MPB-ja, datë 30 shtator 2024, thuhej se tek institucionet qendrore nuk është specifikuar obligimi që kjo përqindje të arrihet në secilin institucion dhe se Rregullorja 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, kuota prej 10% i referohet institucioneve të administratës qendrore si tërësi. Përveç kësaj, vërehet se të dhënat e dërguara nga MPB janë të vitit 2022, e që lënë të kuptohet se autoritetet shtetërore nuk mbajnë shënime në mënyrë të rregullt lidhur me zbatimin e nenit 10 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

KONSTATIMI

34. Avokati i Popullit rikujton se është obligim ligjor që të gjithë kandidatët të mbahen të informuar lidhur me rrjedhën dhe rezultatet në të gjitha fazat e procesit e rekrutimit deri në shpalljen e kandidatëve të përzgjedhur dhe mbylljen e konkursit. KQZ-ja, me dështimin për ta njoftuar ankuesin, jo vetëm që ka shkelur parimet e LPPA-së, por ka shkelur edhe rregulloren e brendshme, sipas të cilës: *“Në çdo rast, NJMBNJ njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit, në çdo hap të vlerësimit.”*
35. Duke u bazuar në përgjigjen nga kryesuesi i KQZ-së se me rastin e mosnjoftimit të kandidatëve, të cilit nuk ishin përzgjedhur për pozitën e shpallura, KQZ-ja ka vepruar njëjtë me të gjithë, pra nuk e ka njoftuar asnjërin nga kandidatët që nuk ishin përzgjedhur, Avokati i Popullit nuk mund të konstatojë që mund të ketë pasur diskriminim ndaj ankuesit. Kjo duke u nisur nga fakti se kandidatët e tjerë që nuk ishin përzgjedhur nuk kishin qenë ekskluzivisht pjesëtarë të njërit apo komunitetit tjetër dhe se nga radhët e kandidatëve ka mundur të kishte edhe kandidatë që i përkisnin komunitetit shumicë në Republikën e Kosovës.
36. Të dhënat që aktualisht Avokati i Popullit i posedon nuk mjaftojnë për të vlerësuar nëse secili institucion veçmas e ka plotësuar kuotën e përcaktuar me ligj, prandaj Avokati i Popullit, tani për tani, nuk mund të japë ndonjë vlerësim nëse KQZ-ja e ka të plotësuar kuotën për të punësuarit nga komunitetet joshumicë.
37. Por Avokati Popullit konstaton se KQZ-ja ka vepruar në kundërshtim me parimet e miradministrimit, të mishëruara në LPPA, si dhe në rregullat e brendshme të KQZ-së.
38. Për sa i përket përfaqësimit në punësim të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në institucionet publike në përgjithësi, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek obligimet kushtetuese të përcaktuara me neni 61 të Kushtetutës si dhe të *Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*.
39. Po ashtu, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen të Ligjit për Zyrtarët Publikë, sipas të cilit kërkohet që kuota e punësimit për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë të jetë 10% e vendeve të punës në institucionet publike; si dhe të Rregullorja 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, neni 13, paragrafi 4, e cila u jep të drejtë institucionet publike, me qëllim të plotësimit të kuotës prej 10%, që mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të nënpërfaqësuar.
40. Nga të dhënat që Avokati i Popullit i ka pranuar nga MPB-ja, të cilat përveçse mund të mos tregojnë gjendjen reale lidhur me punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në institucionet publike, për arsye se janë të dhëna të vitit 2022, ato tregojnë një përqindje shumë të ulët të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.
41. Avokati i Popullit, duke u bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla [...].”*; si dhe: *“Të rekomandojë*

[...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, paragrafi 1.7), i

REKOMANDON

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

1. Me rastin e shpalljes së konkurseve, të veprojë sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin në fuqi për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe në aktet e brendshme të KQZ-së, për t'i mbajtur të gjithë kandidatët të njoftuar gjatë të gjitha fazave të procedurës së rekrutimit.

Ministritë së Punëve të Brendshme:

1. Të veprojë në pajtim me Rregulloren 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, neni 13, par. 4, që përcakton: *“Institucionet publike me qëllim të plotësimit të kuotës si në paragrafin 1 të këtij neni, mund të hapin procedurë të rekrutimit vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të nën përfaqësuar.”*
2. T'i mbajë të përditësuara të dhënat statistikore për numrin e të punësuarve të komuniteteve joshumicë në Kosovë, në institucione publike në nivel qendror. Në kuadër të të dhënave statistikore të përfshihen edhe komunitetet e tjera joshumicë, si: romët, ashkalinjtë, egjiptianët, kroatët dhe malazezët.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*) dhe me nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”*), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit